

A K T T H E M E L I M I
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"ILMA" Sh.P.K.



Themeluesi i Sh.P.K. "ILMA" është : zonja **Merita Boni**, e bija e Benukut dhe e Violetes, shtetase shqiptare, lindur më 04.05.1969, banuese në Tirane, Rruga "Tefta Tashko", pall.176, shk.2, me numër pasaporte Nr.0339893, e cila vendosi të hartojë këtë akt themelimi për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, mbështetur në parimet e mëposhtme :

Neni 1

Themeluesja do të krijojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të cilën do ta quajë "ILMA", Sh.P.K.

Neni 2

Selia e Shoqërisë do të jetë në Tirane, Rruga "Qemal Stafa", 381.
Me vendim të ortakut të vetëm mund të hapen dege, filiale ose perfaqesi, ashtu sikundër do ta shohë të nevojshme Shoqëria, brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Neni 3

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj per një kohezgjatje prej mbi 10 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar, me përashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim të ortakut të vetëm. Po me vendim të ortakut të vetem kohezgjatja e Shoqerise mund te shtyhet tej afatit te percaktuar ne kete nen.

Neni 4

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj :

Importimin, eksportimin dhe tregimin e të gjitha llojeve të mallrave, materialeve, makinerive, pajisjeve dhe impianteve te ndryshme, të karakterit publik, farmaceutik dhe stomatologjik, industrial, bujqesor, tregtar, ushqimor, te sherbimeve etj. në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

Zhvillimin e aktivitetit te turizmit, transportit si: pasagjeresh edhe mallrash te llojeve te ndryshme etj. si dhe te cdo lloj aktiviteti qe do t'i sherbeje realizimit te objektit te shoqerise.

Kryerjen e veprimtarive te sherbimit e riparimit te karakterit mekanik, elektrik, elektronik, komunal e te llojeve te tjera.

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Merita Boni".

Investimin e kapitalit dhe mijete të tjera financiare, për blerje të pasurive të lujtshme dhe të palujtshme dhe në vazhdim të aktivitetit të saj të shesë të tilla, për të arritur qellimet e Shoqërisë, apo të tjera, por që janë të vlefshme për të.

Realizimin e kontratave, marrëveshjeve, ortakërive, shoqërives të përbashkëta apo forma të tjera të lejuara nga legjislacioni shqiptar, me persona fizikë dhe juridikë, shqiptarë ose të huaj, për të realizuar veprimtari të ndryshme që janë të nevojshme dhe me interes për Shoqërinë.

Neni 5

Kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë 100.000 (njëqindmijë) lekë.

Neni 6

Kapitali themeltar është depozituar prej tij në Bankën _____, me një llogari të hapur në emër të shoqërisë në formim e sipër.

Shuma e depozituar vërtetohet me anë të një çertifikate të lëshuar nga ajo Bankë, në të cilën shënohet shuma e kapitalit të derdhur.

Neni 7

Shoqëria do të rregullohet, përvèç këtij akti themelues edhe me norma të përcaktuara në Statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga Ortaku i Vetëm dhe si i tillë do të miratohet në Gjykatën e Rrethit Tiranë në ditën e legalizimit si person juridik në Shqipëri.

Neni 8

Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (katër) ekzemplarë, në gjuhën shqipe, duke patur secili ekzemplar fuqi të njëjtë ligjore.

THEMELUESJA

Merita Boni

Merita Boni

M.Boni

S T A T U T
I SHOQERISE PRIVATE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ILMA" Sh.P.K.



KAPITULLI I

EMRI, FORMA, BAZA JURIDIKE, SELIA, TERRITORI

Neni 1

Emri

Shoqëria tregtare private me pergjegjesi te kufizuar emerthet "ILMA" Sh.P.K., e cila më poshtë do te quhet "Shoqëria", eshte krijuar me pare dhe tanë zoterohet nga ortake e vetme Zonja Merita Boni, shtetase shqiptare, lindur më 04.05.1969, banuese në Tiranë, Rruga "Tefta Tashko" pall.176, shk.2, me numër pasaporte Nr0339893.

Neni 2

Forma

Kjo Shoqeri eshte një Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar dhe i perballon humbjet deri ne kufirin e vleres se kapitalit themeltar.

Neni 3
Baza juridike

Shoqëria është krijuar në baze te legjislacionit te Republikës se Shqipërisë dhe, si person juridik, e zhvillon aktivitetin ne perputhje me kete legjislacion dhe me normat e ketij Statuti. Ajo ka personalitet juridik dhe eshte e regjistruar ne Regjistrin Tregtar prane Gjykatës se Rrethit Tirane.

Neni 4
Selia

Selia e Shoqërisë është ne Tirane, në rrugen "Qemal Stafa" 381. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj me vendim të ortakut të vetëm.

Shoqëria do ta konsiderojë qendrën e vet si Shoqëria Nënë, e cila rast pas rasti do të hapet me anë filialesh ose shoqërish të përbashkëta në të gjitha ato vende ku do të shikojë interes në përmbytjen e qellimit të saj, në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj.

Neni 5
Territori

TIRANË
Shoqëria e zhvillon aktivitetin si në territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu
dhe jashtë saj.

Shoqëria mund të krijojë dege, filiale ose perfaqesi, si ne rrethe te ndryshme te
Republikës se Shqiperise ashtu edhe në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e
vendeve përkatëse.

KAPITULLI II

OBJEKTI DHE KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Neni 6 Objekti

Shoqëria ka si objekt të veprimitarës së saj :

Importimin, eksportimin dhe tregtimin e të gjitha llojeve të mallrave, materialevë, makinerive, pajisjeve dhe impianteve te ndryshme, të karakterit publik, farmaceutik dhe stomatologjik, industrial, bujqesor, tregtar, ushqimor, te sherbimeve etj. në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

Kryerjen e veprimitarive te sherbimit e riparimit te karakterit mekanik, elektrik, elektronik, komunal e te llojeve te tjera.

Zhvillimin e aktivitetit te turizmit, transportit si: pasagjeresh edhe malirash te llojeve te ndryshme, etj. si dhe te cdo lloj aktiviteti qe do t'i sherbeje realizimit te objektit te shoqerise.

Investimin e kapitalit dhe mjete të tjera financiare, për blerje të pasurive të lujtshme dhe të palujtshme dhe në vazhdim të aktivitetit të saj të shesë të tilla, për të arritur qëllimet e Shoqërisë, apo të tjera, por që janë të vlefshme për të.

Realizimin e kontratave, marrëveshjeve, ortakërive, shoqërive të përbashkëta apo forma të tjera të lejuara nga legjislacioni shqiptar, me persona fizikë dhe juridikë, shqiptarë ose të huaj, për të realizuar veprimitari të ndryshme që janë të nevojshme dhe me interes për Shoqërinë.

Neni 7 Kohezgjatja

Shoqëria do të zhillojë aktivitetin e saj per mbi 10 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar, me përashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim të ortakut të vetëm. Po me vendim te ortakut te vetem kohezgjatja e Shoqerise mund te shtyhet tej afatit te percaktuar ne kete nen.

KAPITULLI III

AUTORITETI I ORTAKUT, LIBRI I SHOQERISE, KONFIDENCIALITETI

Neni 8



Fusha e autoritetit te ortakut

Fusha e autoritetit te ortakut dhe përqindja e fitimeve ose humbjeve do te kenë si kriter baze kapitalin e Shoqërisë, si dhe kompetencat që gëzon ortaku në marrjen e vendimeve të çdo karakteri, të përcaktuara në këtë statut.

Neni 9 Libri I Shoqerise

Për të saktësuar veprimitarë e vet ekonomike si dhe marrëdhëniet e punës, Shoqëria do të çelë librin e vet, i cili do të quhet Libri i Shoqërisë.

Neni 10 Konfidencialiteti

Ortaku i vetëm si dhe personat e tjerë të pranuar në Shoqëri, bien dakord që të mos i ekspozojnë asnjë personi të Jashtëm informacionet që do të disponojë Shoqëria, kontratat që ajo do të lidhë, çdo lloj materiali, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj.

Neni 11 Dokumentet e destinuara per te tretet

Të gjitha aktet dhe dokumentet që nxirren nga Shoqëria dhe të destinuara për të ~~do~~, si letrat, faturat, lajmërimet dhe publikimet e ndryshme, etj. duhet të tregojnë lexueshmë emrin e Shoqërisë dhe pas tij fjalë "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose inicialet "Sh.P.K.", si dhe emrin e administratorit.

KAPITULLI IV

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET DHE TRANSFERIMI I TYRE

Neni 12 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 (njëqindmijë) lekë.

Ky kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga ortaku i vetëm Shoqëria mund ta shtojë ose zvogeloje kapitalin, ne varesi te nevojave dhe rezultateve te saj, sipas vendimit të ortakut të vetëm.

Neni 13 Kontributet

Kapitali themeltar përbëhet nga kontributi i mëposhtëm :
Zonja Merita Boni ka derdhur shumën prej 100.000 (njëqindmijë) lekë.

Neni 14 Pjeset e kapitalit themeltar

Kapitali themeltar është i ndarë në 20 pjesë plotësisht të shlyera, me vlerë 5.000 lekë secila, të renditura sipas numrit të serisë nga 1 në 20.

A handwritten signature in black ink, appearing to read "M. Buri".



Neni 15
Lenia dhe transferimi I pjeseve te kapitalit

Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm tek personat e tretë, në qoftë se ortaku i vetëm vendos për këtë. Ai mund te libet peng sipas legjislacionit ne fuqi. Gjithashtu kapitali themeltar eshte lirisht i trashegueshem në rruge trashëgimie. Bashkeshori, paraardhesit dhe pasardhesit mund te behen ortak nepermjet transferimit te pjeseve te kapitalit themeltar, me vendim te ortakut te vetem dhe sipas kushteve qe lejohen ne ligj.

Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vërtetohen me akt notorial.

KAPITULLI V

STRUKTURA, ORGANET DREJTUESE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 16

Presidenti

Si organ i vetem drejtues i Shoqerise eshte Presidenti i saj. President i Shoqerise eshte ortaku i vetem, me iniciativen dhe kapitalin e te cilit vepron Shoqeria.

Neni 17

Kompetencat e Presidentit

Per sa kohe qe Shoqeria do te perbehet nga nje ortak i vetem, kompetencat e presidentit te saj (i cili eshte ortaku i vetem) do te jene:

Vendos per ndryshimet ne Statutin e Shoqerise dhe perpilon ose miraton rregulloret per Shoqerine apo per sektore te veçante te veprimitarise.

Vendos per politiken afariste te Shoqerise dhe percakton fushat konkrete te veprimitarise se saj.

Emeron dhe shkarkon administratoret e Shoqerise dhe detajon kompetencat e tyre te percaktuara ne Statut.

Kur e shikon te nevojeshme emeron drejtorin ekzekutiv te Shoqerise apo te sektoreve te vaçante te saj, duke caktuar ne aktin e emerimit edhe kompetencat e tij, kohezgjatjen ne pune etj..

Shqyrton bilancin vjetor, percakton llojet e fondeve te ndryshme dhe masen e tyre, fitimin e realizuar si dhe vendos per marrjen e krediv

Vendos per krijimin e degeve (filialeve) ose te perfaqesive si dhe per krijimin e shoqerive me persona te tjere fizike apo juridike.

Vendos per mbarimin e Shoqerise, likujdimin e saj si dhe per shnderrimin e Shoqerise nga shoqeri me perqyegjesi te kufizuar ne shoqeri te formave te tjera.

Realizon marredheniet me te rendesishme ekonomike dhe financiare te Shoqerise me persona te tjere fizike apo juridike, vendas apo te huaj.

Vendos çmimet e shitjes, te sherbimeve etj..

Vendos per pagat e te punesuarve ne Shoqeri.

Perveç kompetencave te lartepermendura, te cilat jane ekskluzive per te, Presidenti, ne rastet kur nuk ka emeruar administrator, kryen dhe kompetencat qe ne kete Statut jane percaktuar per kete te fundit.

Neni 18 Administratori dhe kompetencat e tij

Kompetencat e administratorit ose te administratoreve, ne menyre konkrete dhe te detaujar percaktohen ne aktin e tyre te emerimit. Veç te tjera qe mund te detajohen ne kete akt, administratori ka edhe keto kompetencia:

Kujdeset per funksionimin e perditshem normal te Shoqerise ose te nje pjese te aktivitetit ekonomik dhe financiar te saj, sipas percaktimit ne aktin e emerimit.

Pergatit dokumentacionin dhe raportet e ndryshme per gjendjen ekonomike dhe financiare te Shoqerise sipas legjisacionit ne fuqi dhe ia paraqet presidentit per shqyrtim.

Koordinon veprimtarine e personave te punesuar ne Shoqeri

Shqyrton ofertat dhe pergaatit kerkesa te cilat ia paraqet presidentit per miratim.

Ndjeq problemet e Shoqerise ne marredhenie me organet shteterore ose cakton ndonje prej personelit per trajtimin e ketyre problemeve

I propozon presidentit çmimet e shitjes dhe te sherbimeve si dhe pagat per personelin e punesuar ne Shoqeri.

I propozon presidentit rregulloret per sektore te veçante te Shoqerise.

Emërimi i administratorit do te bëhet për një afat prej 3 (tre) vitesh financiare, me përjashtim të rasteve të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm.

Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve qoftë për shkelje ligjore, qoftë për shkelje të statutit ose për faje të kryera gjatë administrimit të tij.

KAPITULLI VI

LIBRAT E SHOQERISE, BILANCI, DIVIDENTET

Neni 19 Librat e Shoqerise

A handwritten signature in black ink, appearing to read "M. Bozif".

Shoqëria është e detyruar të mbajë, përvç Librit te Shoqërisë, në të cilin shënohet emri i plotë i ortakut dhe kapitali themeltar, si dhe vendimet e ortakut të vetëm, edhe dokumentacionin kontabel dhe librat e tjere.

Neni 20
Bilanci

Bilanci mbylljet në 31 dhjetor të çdo viti, ku i pari do të jetë 31 dhjetori i vitit 2002.

Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabel i autorizuar nga ortaku, miratohen nga ortaku i vetëm.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

Neni 21
Dividentet

Ortaku i vetem miraton llogarite vjetore dhe evidenton ekzistencen e fitimit. Ai percakton fitimin e vitit financiar, te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per rezerven sipas ligjit ose te percaktuar nga vete ortaku; fondet e tjera që shihen te nevojeshme dhe, nga ana tjeter i jane zbritur ose shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mepareshme. Keshtu ortaku i vetem përcakton dhe dividentin.

KAPITULLI VII

MBARIMI DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Neni 22
Mbarimi

Shoqëria mbaron me vendim të ortakut të vetëm ose kur ka një prishje të parakohshme për arsyet e parashikuara në ligj.

Neni 23
Likujdimi

Shoqëria hyn në procesin e likujdimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi ortaku cakton një ose disa likujdues, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit të Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likujdimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.

Në fund të procesit të likujdimit, ortaku i vetëm vendos mbi bilancin përfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit të likujdimit.

Mbas pagimit të kreditorëve ortaku i vetëm mban pjesën e mbetur të kapitalit.

KAPITULLI VII

MOSMARREVESHJEVET DHE DISPOZITA TE FUNDIT

A handwritten signature in black ink, appearing to read "M. Bury".

Neni 24
Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së Shoqërisë ose gjatë periudhës së likujdimit do t'i paraqiten për zgjidhje gjykatës kompetente shqiptare.

Neni 25
Dispozita te fundit

Pasuria e Shoqerise mund te sigurohet ne ndonje Institut Sigurimi si brenda ashtu edhe jashte Shqiperise.

Shoqeria do te kete vulen e saj, forma dhe madhesia e se ciles do te percaktohen nga presidenti.

Ky Statut është hartuar në 4 (katër) ekzemplarë, në gjuhën shqipe, duke patur secili ekzemplar fuqi të njëjtë ligjore.

ORTAKU I VETEM
Merita Boni

Merita Boni
M.Boni